



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 349/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së posterave shenjat publike të trafikut, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1350(njëmijë e treqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 25. 10. 2013 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 23 tetor 2013 në rrugën Busavatë - Dardanë anëtarët e subjektit politik PDK kanë vendosur posterat e kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt politik Begzad Sinanit mbi shenjat e komunikacionit. Parashtruesi i ankesës me këtë rast thekson se subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LVP-së dhe se si dëshmi ka bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, datën 26.10.2013 informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 28.10.2013, ora 10:00.

PZAP-i sipas afatit të paraparë pra me datën 28.10.2013 pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza lidhur me shkeljen e nenit 33 pika b) të LVP-së dhe se sipas të dhënave që kanë nga tereni persona të pidentifikuar kanë vendosur posterat e kandidatit në fjalë me qëllim të dëmtimit të partisë, andaj sipas PDK-së edhe përkundër kësaj me të kuptuar për këtë posterët në fjalë janë larguar menjëherë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresave të lëndës, shihen se si posterat e kandidatit të PDK-së për kryetar komune në Kamenicë Begzad Sinani janë të vendosura në shenjat publike publike të trafikut, veprime këto të cilat janë të ndaluara me dispozitat ligjore të LZP-së konkretisht me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe nenin 4.1 paragrafi b) i Rregullës Zgjedhore 11/2013 andaj me këtë rast PDK konsiderohet përgjegjëse veprimet e tilla.

Prandaj PZAP-i për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, për këtë çështje mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK shkelje të natyrës së tillë ka kryer edhe më parë dhe konsiderohet si recidivist, si rrethanë tjetër rënduese mori atë se subjekti politik PDK edhe më parë ka marr pjesë në zgjedhje dhe se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Andaj vendosjen e posterave e kandidatëve të saj në objektet publike e bëjnë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime konkrete duke i larguar menjëherë posterat e kandidatit të saj nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i duke i marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjës për veprimet e tilla dhe se mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 118.1 lidhur me nenin 120.1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 349/2013 më datën 31.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*